



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr 04/ Prot

Tiranë, më 20.01.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datën 20.01.2020 ditë e hënë, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u mbajt mbledhja plenare e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mblidhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahimimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Arben Dollapaj
6. Bujar Sheshi
7. Kosta Beluri
8. Vate Staka
9. Sander Beci
10. Esmeralda Keshi

Nuk janë të pranishëm anëtarët:

1. Besnik Cani.

Gjithashtu, janë të ftuar të jenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT dhe EURALIUS, Ministria e Drejtësisë si dhe vezhgues nga organizata të tjera.



Nga administrata e KLP janë të pranishëm:

1. Sekretari i Përgjithshëm znj. Ilirjana Nano
2. Drejtori i Kabinetit znj. Edlira Cimbi
3. Shefi i sektorit të dokumentimit të seancave plenare, z. Frederik Sulisufi.

Mbledhja e u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Gent Ibrahimi i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, pasi konstaton vlefshmërinë e mbledhjes, bën hapjen e saj dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i projektaktit për pranimin e dorëheqjes së kancelares së Prokurorisë së Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Miratimi i projektaktit për komandimin e magjistrates Pranvera Pustina si ndihmësmagjistrate në Prokurorinë e Përgjithshme.
3. Miratimi i projektaktit për komandimin e magjistratit Ols Dado si ndihmësmagjistrat në Prokurorinë e Përgjithshme.
4. Miratimi i projektaktit për komandimin e magjistratit Arens Cela si ndihmësmagjistrat në Prokurorinë e Përgjithshme.
5. Miratimi i projektaktit për miratimin e relacioneve për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatëve për t’u emëruar magjistrat Prokuror, pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019. (për 10 magjistratët e rinj)
6. Projekt akti për shpalljen e vakancave për emërimin e magjistratëve të rinj.
7. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime).

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për pranimin e dorëheqjes së kancelares së Prokurorisë së Apelit Durrës.*

Z. Ibrahimi relatton çështjen. Më datën 13.01.2020 pranë KLP, është regjistruar kërkesa për dorëheqjen e kancelares së Prokurorisë së Gjykatës së Apelit, Durrës, për arsye familjare. Citon nenin 100, pika 3 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, neni 64 i ligjit “Për nëpunësin civil”, nenin 149/a, Kushtetutës, 164/e, 166/2, 189/1 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke argumentuar se kërkesa është e bazuar në ligj, Kryetari propozon miratimin e saj.



Z. Ibrahimi hedh në votim miratimin e projekt vendimin.

Miratohet me 10 vota pro.

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e dytë të të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për komandimin e magjstrates Pranvera Pustina si ndihmësmagjistrate në Prokurorinë e Përgjithshme.*

I kaloj fjalën z. Beci, si relator në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Beci relaton se komisioni ka përgatitur nga një opinion për secilin prej komandimeve të magjistratëve pranë Prokurorisë së Përgjithshme, të cilët janë publikuar në faqen zyrtare të KLP. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53, 54/4, 56 dhe nenin 58 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, shpalli hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga rradhët e prokurorëve për tu komanduar me pëlqimin e tyre në pozicionin e Drejtor Kabineti pranë Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Dekriminalizimit si dhe pozicionin e specialistit ndihmësmagjistrat në Drejtorinë e Studimeve të Inspektimit dhe të Çështjeve të tjera Ligjore. Komisioni ka përgatitur një projekt opinion për çdo kandidat dhe ka vlerësuar nëse komandimi është në përputhje me interesat e larta të Prokurorisë ku ushtron profesionin magjistrati. Komisioni, bazuar sa më lart, si dhe në shkresën zyrtare të Prokurorit të Përgjithshëm, i propozon Këshillit komandimin e znj. Pustina për një periudhë 5 vjeçare, duke filluar nga data 20.01.2020.

Z. Ibrahimi pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Bazaj kërkon ti vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni.

Z.Dollapaj propozon që të hiqet pjesa e caktimit në pozicionin e Drejtorit të Kabinetit, të ndryshohet me: komandim në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Prokurorisë të Përgjithshme.

Z. Ibrahimi hedh në votim projekt vendimin me ndryshimin e propozuar dhe dakordësuar.

Znj. Seiti sqaron se, nuk është kompetencë e Këshillit të përcaktojë organikën e Prokurorit të Përgjithshëm, konfirmon përcaktimin komandimin si ndihmësmagjistrat pranë Prokurorit të Përgjithshëm.



Z. Ibrahimi hedh në votim miratimin e projekt vendimin.

Miratohet me 10 vota pro.

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për komandimin e magistratit Ols Dado si ndihmësmagjistrat në Prokurorinë e Përgjithshme.*

I kaloj fjalën z. Beci, si relator në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Sqaron se edhe në rastin e këtij magistrati është ndjekur e njëjta procedurë. Komisioni, referuar shkresës së Prokurorit të Përgjithshëm, i propozon Këshillit komandimin e z. Dado si ndihmësmagjistrat, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Dekriminalizimit për një periudhë 5 vjeçare, duke filluar nga data 20.01.2020.

Z. Ibrahimi rikujton që edhe për këtë çështje të zëvendësohet togfjalëshi: Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve, të zëvendësohet me togfjalëshin “ndihmësmagjistrat”.

Z. Ibrahimi hedh në votim projekt vendimin me ndryshimin e bërë dhe të dakordësuar.

Miratohet me 10 vota pro.

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e katërt të të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për komandimin e magistratit Arens Çela si ndihmësmagjistrat në Prokurorinë e Përgjithshme.*

I kaloj fjalën z. Beci, si relator në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Sqaron se edhe në rastin e këtij magistrati është ndjekur e njëjta procedurë. Komisioni, bazuar në procedurën e ndjekur dhe kërkesën e Prokurorit të Përgjithshëm, i propozon Këshillit, komandimin e z. Çela pozicionin e ndihmësmagjistratit, në Drejtorinë e Studimeve të Inspektimit dhe të Çështjeve të tjera Ligjore për një periudhë 5 vjeçare, duke filluar nga data 20.01.2020.

Z. Ibrahimi propozon që paragrafit të parë të projekt vendimit, ti hiqet termi “specialist” si dhe togfjalëshi “në Drejtorinë e Studimeve të Inspektimit dhe të Çështjeve të tjera Ligjore”.

Konstaton që data në të gjitha aktet duhet të jetë data 20.01.2020.

Z. Ibrahimi hedh në votim projekt vendimin me ndryshimet e bëra dhe të dakordësuar.

Miratohet me 10 vota pro.



Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e pestë të të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për miratimin e relacioneve për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatëve për t'u emëruar magjistrat Prokuror, pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019. (për 10 magjistratët e rinj)*

I kaloj fjalën anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit dhe Etikës Profesionale, të cilët në mënyrë të përmbledhur i propozojnë Këshillit miratimin e relacioneve për raporteve të verifikimit të pasurisë dhe figurës, për 10 magjistratët (neni 32 i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”) në Republikën e Shqipërisë.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Bazaj ngre shqetësimin që anëtarët duhet të njihen me dokumentacionin për këta kandidatë magjistratë, para se relacioni të paraqitet në mbledhjen plenare. Z. Bazaj e gjykon të pamjaftueshëm faktin që ky dokumentacion të jetë i shqyrtuar nga Komisioni i Vlerësimit. Citon nenin 164 pika 5 dhe 6 të ligjit 115/2016 (“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”).

Z. Beluri kundërshton këtë shqetësim të z. Bazaj.

Z. Ibrahimi sqaron se është një dokumentacion shumë voluminoz dhe e bën të pamundur vënien në dispozicion për çdo anëtar, por çdo anëtar është i lirë të kërkojë dokumentacionin dhe të ketë mundësi të njihet me to. Mundësia i është dhënë çdo anëtari të njihet pranë Komisionit të Vlerësimit dhe Etikës Profesionale ku ndodhen dosjet.

Znj. Seiti ndan të njëjtin mendim me z. Ibrahimi, si dhe sqaron se termi “emërim” nuk është i duhuri për këtë rast, Këshilli i jep statusin, kurse emërimi është organika që përputhet me vendin e punës së magjistratit.

Z. Ibrahimi sqaron se Këshilli vetëm miraton relacionet, ndan të njëjtin mendim dhe Z. Balla.

Z. Dollapaj propozon të riformulohet pika 2 e relacionit, sipas ligjit parashikohet që pasi jepet statusi pastaj emërimi. Statusi merret vetëm nëpërmjet emërimit.

Z. Ibrahimi pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Sheshi dakord për miratimin e relacionit. Vendimi i Këshillit duhet të publikohet në faqen zyrtare të Këshillit por jo relacioni, ka të dhëna sensitive.

Z. Beluri shprehet se kandidatit i vihet në dispozicion përveç vendimit dhe relacioni (të cilit duhet ti hiqen të dhënat sensitive). Propozon frazën: lejim dhe kandidim, meqë këto terma janë përdorur dhe te Rregullorja.



Z. Ibrahimimi propozon që ose të mos bëhet publik relacioni ose të vihet në dispozicion i redaktuar.

Z. Balla dhe z. Sheshi propozojnë që të shtohet: miratimin e relacionit të kandidatit për prokuror dhe lejimit duke e konsideruar të pranueshëm kandidatin ...

Znj. Keshi propozon: miratimin e relacionit të kandidatit për prokuror sipas tekstit bashkëlidhur, duke lejuar kandidimin e tij.

Z. Sheshi propozon: miratimin e relacionit dhe lejimin e kandidimit dhe jo emërimin.

Z. Dollapaj shtron pyetjen nëse do të përdoret fjala relacion apo raport.

Z. Ibrahimimi sqaron se ligji e përdor fjalën raport dhe Këshilli këtë do të përdor.

Z. Ibrahimimi hedh në votim miratimin e relacionit të kandidatit për prokuror sipas tekstit bashkëlidhur dhe shprehjen “duke lejuar kandidimin e tij”.

Miratohet me 9 vota pro. Z. Bazaj kundër (pjesërisht). Do të shprehet me opinion për këtë çështje.

Z.Ibrahimimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës.

➤ *Projekt aktin për shpalljen e vakancave për emërimin e magistratëve të rinj.*

I kaloj fjalën z. Beci, në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Në përputhje me nenin 149 të Kushtetutës, nenin 35/3, nenin 39/1 të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka nisur procedurat për shpalljen e vendeve të lira dhe plotësimin e strukturës organike të prokurorive. Relaton ndryshimet e mëposhtme, bërë me dije me shkresat e Prokurorit të Përgjithshëm, të cilat janë si më poshtë:

- Prokurorisë Korçë i shkurtohet në organikë një vend për prokuror dhe i shtohet Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë një vend.
- Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë: Pukë, Vlorë, Shkodër, Kurbin, shkurtohen në organikë një vend për prokuror, prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, dhe Gjirokastrë, i shtohen dy vende, Berat i shtohet një vend.

Këto ndryshime janë marrë duke pasur në vëmendje ngarkesën e punës.

Gjithashtu janë evidentuar dhe vendet e lira ekzistuese. Këshilli me shpalljen e këtyre vendeve (në përputhje me ligjin 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”), hap procedurën e shpalljes duke ftuar magistratët e profilit prokuror të diplomuar në vitin akademik 2018-2019, të paraqesin një kërkesë me shkrim duke shprehur parapëlqimin e tyre për 3 prej vendeve vakante,



Jo më vonë se dy javë kalendarike nga miratimi i vendimit. Komisioni i propozon Këshillit, shpalljen e 10 vendeve të lira për caktimin e të emëruarëve nga rradhët e magjistratëve të rinj, vende të cilat do publikohen menjëherë në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Beci vë në dijeni Këshillin për administrimin e kërkesës nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, të njëjës nga kandidatet për magjistrat, pjesë e listës së magjistratëve që priten të emërohen, e cila kërkon shtyrjen e kandidimit të saj për shkaqe shëndetësore.

Rreth kësaj çështje u diskutua, dhe u vendos që Komisionit të Karrierës ti lihej koha e duhur për të shqyrtuar kërkesën, si dhe për ta relatuar në mbledhjen e rradhës.

Z. Ibrahim hedh në votim vendimin për shpalljen e vendeve të lira për kandidatët për prokuror.

Miratohet me 10 vota pro.

Në përfundim, Këshilli në mbledhjen e sotme plenare miratoi Vendimet për gjashtë pika të rendit të ditës si dhe u shpreh lidhur me një çështje që iu shtua rendit të ditës përmendur më lart (çështja e magjistrates së sipërpërmendur)

Në përfundim duke mos patur pika të tjera për diskutim Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)

KRYETARI

Gent Ibrahim

Shënim:

(Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit)

Lidhur me këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___ 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___ (Bashkëngjitur kopjet e dokumenteve)
Procesverbal i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë ___ / ___ /2020
Procesverbal i të arkivohet

PËRGJEGJËSI SEKTORIT SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi